



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT TË KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL
PROTECTION AGENCY

Instituti për Planifikim Hapësinor – Institute for Spatial Planning – Institut za Prostorno Planiranje

DATË/A:	04-07.02.2013
REFERENC-Ë:	AMMK 2013
PËR/ZA/TO:	Dr.sc Ilir Morina, Kryeshef Ekzekutiv
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Luan Nushi, drejtor në IPH
NGA/OD/FROM:	Festa Nixha-Nela, Planer hulumtues
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport nga pjesëmarrja ne punëtorinë e FLTK për Partesh

I nderuari z. Kryeshef,

Të bashkëngjitur e keni raportin nga pjesëmarrja në punëtorinë e FLTK të komunës së Parteshit e përfshirë në Programin "Planet Lokale të Trashëgimisë Kulturore 2012-2015" e organizuar nga CHwB, ku edhe IPH/MMPH është pjesë e memorandumit të nënshkruar më parë.

Me respekt,





Raport nga pjesëmarrja në punëtorinë për "Planet Lokale të Trashëgimisë Kulturore 2012-2015" për
komunën e Parteshit

Raport


Punëtorja dhe vizita studimore

në Malin e Zi

04-07.02.2013

Festa Nixha-Nela

Instituti për Planifikim Hapësinor
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor





Vendi: Hotel Solid Suharekë,
Kotorr, Perast - qytete në Mal të Zi

Data: 04-07.02.2013

Organizatori: CHwB - Trashëgimia Kulturore pa Kufij
Programi - "Planet Lokale të Trashëgimisë Kulturore 2012-2015"

Pjesëmarrësit: Përfaqësues të MMPH-së - Departamenti për Planifikim Hapësinor dhe
Instituti për Planifikim Hapësinor; Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit;
Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë; Përfaqësues të komunës së
Parteshit si dhe përfaqësues të CHwB-së.



Qëllimi i punëtorisë: Caktimi i objektivave dhe prioriteteve të projekteve dhe aktiviteteve të propozuara për Planin Lokal të Trashëgimisë Kulturore të komunës së Parteshit.

Qëllimi i vizitës studimore: Njohja me praktikën e vendeve të rajonit lidhur me mbrojtjen, menaxhimin, promovimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.



1

Është diskutuar dhe debatuar për gjendjen ekzistuese dhe të ardhmen e trashëgimisë kulturore për komunën e Parteshit.

Mozaiku i trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Është pregatitur harta e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, e ndarë me fotografi në formë mozaiku. Është bërë ndarja në 2 grupe dhe është zhvilluar gara për atë se sa e njohim TKN të Kosovës?



Prezantimet

MKRS - "Sistemi i mbrojtjes dhe legjislatura e TK në Kosovë"

MMPH - "Sistemi i planifikimit hapësinor - Përfshirja e TK në PH"

SWOT analiza e përgjithshme - për temën:

"Gjendja e TK dhe TN në komunën e Parteshit"

Përparësitë • Institucionet lokale; • Tokë bujqësore e kualitetit të lartë; • Panairët tradicionale në tri fshatra; • Lumi; • Veshjet tradicionale; • Shtëpi tradicionale; • Jasen: lloq shërues; • Afërsia me shtetin e Serbisë dhe Maqedonisë; • Gjetje arkeologjike.	Dobësitë • Mungesa e birosë turistike; • Infrastruktura e dobët; • Mungesa e kapacitetit human; • Mungesa e shfrytëzimit të tokës bujqësore; • Vërshimet; • Mungesa e edukimit të popullatës për TK.
Mundësitë • Zhvillimi i eko-turizmit; • Eko-shtëpia - me mundësi ekspozimi të veshjeve popullore; • Bashkëpunimi ndërshtetëror në fushën e turizmit.	Rreziqet • Tërmetet





SWOT strategjik

Cila është strategjia që të gjitha Dobësitë dhe Rreziqet të shëndrohen në Përparësi apo Mundësi?

Ngritja e vetëdijes për TK të komunës së Parteshit	Zhvillimi i turizmit lokal
1. Ndarja e buxhetit për TK përmes projekteve dhe përkrahjes nga niveli qendror dhe lokal; 2. Organizimi i ligjëratave në shkolla për çështjen e TK; 3. Organizimi i manifestimeve kulturore; 4. Organizimi i ekspozitave tradicionale.	1. Ndërtimi i një biroje turistike 2. Shtypja e fletushkave dhe broshurave; 3. Edukimi dhe aftësimi i kuadrit profesional - ciceron turistik.

Pestel analiza

Ofron një mundësi të mirë të analizimit dhe zbërthimit të ndikimeve pozitive apo negative të elementeve (Politik, Ekonomik, Socio-kulturor, Teknologjik, Ekologjik/Mjedisor, Legjislativ) që kanë në TKN. Pestel analiza është realizuar përmes një pyetësori i cili është plotësuar nga secili anëtar i forumit.

2

Caktimi i objektivave dhe prioritizimi i projekteve dhe aktiviteteve për Planin Lokal të Trashëgimisë Kulturore të komunës së Parteshit

Është punuar në 3 grupe, janë marrë parasysh strategjitë nga dita e kaluar, janë grupuar në tri tema për të cilat janë listuar projektet dhe aktivitetet e caktuara.

1. Mbrojtja dhe konservimi i TKN/ Trajtimi i objekteve historike dhe zonave me TN;
2. Integrimi i TK në jetën bashkëkohore dhe zhvillimi lokal përmes TK/ Trajtimi hapësinor dhe zhvillimor i TKN;
3. Edukim, trajnim, vetëdijësim mbi TK/ Aspekti human mbi TKN.

Rezultatet për temën e tretë

Prioriteti Gr.3	Projekti aktiviteti	Kohëzgjatja	Inicues Bartës Pronar	Implementues	Relevanca	Buxheti
1	Hapja e birosë turistike • Pamfleti • Harta turistike	3 muaj	Komuna MKRS MMPH CHwB NGO Donator	Komuna MKRS CHwB	Ngritja e vetëdijes për çështjen e TKN	
2	Aftësimi i kuadrit komunal për mbrojtje të TK dhe përgatitjen e projekteve për TKN	3-6 muaj	Komuna MKRS CHwB NGO	Komuna MKRS CHwB	Aftësimi profesional i kuadrit kom. për TKN	
3	Ligjërime në shkolla fillore dhe të mesme për çështjen e TKN	1 herë në muaj	Komuna MKRS CHwB	Ekspertë nga Komuna MKRS	Arsimimi i të rinjëve për fushën e TKN	
4	Organizimi i ekskurzioneve kolektive, vizita e vendeve tjera të Kosovës dhe shkëmbimi i eksperiencave lidhur me TKN	1-2 herë në vit	Komuna MKRS CHwB	Komuna MKRS CHwB	Ngritja e arsimimit dhe krijimi i njohurive të reja për TKN	



3 Të dhënat e përgjithshme për Malin e Zi

Mali i Zi është një vend në Evropën Juglindore, i cili shtrihet në brigjet e Detit Adriatik. Ai kufizohet në lindje me Kosovën, në VL me Sërbinë, në VP me Bosnën dhe Hercegovinën, në perëndim me Kroacinë dhe në Jug me Shqipërinë.

Mali i Zi është anëtar i Kombeve të Bashkuara dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian, si dhe kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian nga viti 2010, dhe kandidat potencial për NATO.

Sipërfaqja e Malit të Zi është 13.812 km², e përbërë nga 21 komuna: Plevle, Bjelo Pole, Berane, Rozhajë, Zhablak, Mojkovc, Pluzhinë, Shavnik, Kolashin, Andrijevicë, Plavë, Nikshiq, Danilovgrad, Podgoricë, Cetinje, Kotor, Herceg Novi, Tivat, Budva, Tivar dhe Ulqin. Në Mal të Zi janë 1256 vendbanime, 40 prej të cilave janë të tipit të qytetit;

Forma e qeverisjes - Republikë Parlamentare, që e fitoi pavarësinë së fundmi, pas referendumit të vitit 2006. Ka kryetarin e shtetit, kryeministrin e shtetit, Kryetarin e Kuvendit, Ministra si dhe autoritete tjera përcjellëse për qeverisje të shtetit të Malit të Zi

Kryeqyteti i shtetit është Podgorica, me 136.473 banorë;



Flamuri dhe stema e Malit të Zi

Sipas regjistrimit të popullësisë së 2003, numri i përgjithshëm i banorëve të Malit të Zi është 620.029, me përbërjen etnike: malazias (44.69%), Serbë (29.02%), Boshnjak (8.65%), Shqipëtar (5%), Musliman (3%) dhe pjesa tjetër janë Kroat.

Gjuha zyrtare është gjuha malaziasë, ndërsa gjuhët tjera janë: gjuha serbe, boshnjake, shqipe dhe kroate.

Valuta €

Emri Mal i Zi daton që nga shekulli XIII, dhe supozohet që emërtimi vjen nga dendësia e pishave që e kanë mbuluar një sipërfaqe të madhe të këtyre anëve.

Maja më e lartë malore është Zla Kolata në kuadër të Bjeshkëve të Nemuna me lmb. 2534m'.

Gjiri i Boka Kotorrit përbëhet nga katër gjinjë: ai i Toplanit, Tivatit, Risanit dhe Kotorrit;





Liqeni më i madh i Malit të Zi është Liqeni i Shkodrës me sipërfaqe nga pjesa e Malit të Zi 221.8km²
Rrafshina e Zetës shtrihet përgjatë lumit Moraça dhe Zeta deri në fushën e Nikshiqit. Toka pjellore, sasia e mjaftueshme e ujit dhe klima mesdhetare e bëjnë këtë pjesë më pjelloren në Mal të Zi.

Lumi më i gjatë - Tara 141km';



Sipas përkatësisë fetare përqindja më e madhe e popullësisë i takon besimit ortodoks (72%), musliman (19.11%), Katolik (3.5%) e të tjerë.

Ekonomija e Malit të Zi - Pasuria më e madhe e këtij vendi janë mineralet e boksitit, hekurit dhe qymyrit. Veprimtaritë kryesore janë: përpunimi i duhanit, kripës dhe aluminit. Nga kulturat bujqësore kultivohen: drithrat, patatja, duhani, rrushi, ullinjtë dhe fiqtë.

Prodhimi i energjisë elektrike në Mal të Zi bëhet nga termocentrali "Plevla" dhe hidrocentraleve "Mratinje" dhe "Peruçica". Me këto kapacitete që i ka ky vend nuk i përmbush nevojat e konsumuesve të energjisë elektrike, kështu që janë të detyruar të importojnë. Në të ardhmen planifikojnë që të ndërtojnë edhe disa hidroelektrana tjera.

Trafiku në Mal të Zi- Duke e ditur pozitën e saj gjeografike si vend mesdhetar dhe ballkanik, trafiku kryesor është ai detar. Gjiri i Bokës së Kotorrit është një qendër e vjetër detare e pjesës së Adriatikut, e cila sot ka një rëndësi të madhe ekonomike për vendin.

Në Mal të Zi janë dy vija hekurudhore me një gjatësi 250km', Tivar- Podgoricë dhe Nikshiq-Podgoricë.


Gjatësia e përgjithshme e rrugëve në Mal të Zi është 7.000km', me rrugë magjistrale dhe regjionale prej 1847km'.

Në Mal të Zi janë dy aeroporte, ai i Podgoricës dhe Tivatit;

Turizmi - Mali i Zi ka kushte shumë të mira për zhvillim të llojeve të ndryshme të turizmit, me plazha shumë të bukura, me atraksione malore, me trashëgimi kulturore dhe natyrore të pasur dhe të mbrojtur në masë të madhe.

Pothuajse të gjitha veprimtaritë ekonomike janë të orientuara në zhvillim të turizmit. Destinimet më të njohura turistike në Mal të Zi janë: Boka e Kotorrit, Qyteti i vjetër i Kotorrit, Shën Stefani, Budva, Ulqini dhe Buna, Parku Nacional Lovqen, Cetinja, Durmitori etj.

Parqet Nacionale të Malit të Zi: Parku Nacional Durmitor; Biogradska gora; Lovqen; Liqeni i Shkodrës dhe Parku Nacional i Bjeshkëve të Nemuna.





Vizita qytetit të **Kotorrit**



Kotorri qytet, komunë dhe port në bregdetin e Malit të Zi, pjesë VL e Gjirit të Kotorrit. Qyteti është i rrethuar me mure të vjetra, me gjatësi prej 4km' dhe i përbërë nga tri hyrje.

Kotorri është i përbërë nga trekëndëshi ku në njërin anë është i kufizuar nga deti, në pjesën tjetër nga lumi Shkurda dhe me bregun Shën Ivan, në majen e të cilit gjendet kalaja Shën Gjovani. Qyteti i Kotorrit gjatë historisë së saj ka pasur qeverisje dhe administrime të ndryshme. Në fillim qyteti do të qeveriset nga Ilirët nga shek. III-168 p.e.r., kur e okupojnë Romakët deri në vitin 476. Më pastaj Kotorri hyn nën sistemin Bizantin deri më 1185. Dinastia e Nemanjiçëve do të udhëheqë vendin deri më 1371, ku pastaj do të sundojë mbreti kroat Ludovik e më pastaj mbreti boshnjak Tvrtko prej 1384-1391. Kotorri do të jetë Republikë e Pavarur në vitet 1391-1420. Republika e Venedikut do të qeverisë në periudhën 1420-1797 (më shumë se 300vjet). Periudha e parë e sundimit Austriak do të jetë 1797-1805. Qeverisja nga Franca do të jetë deri më 1813. Periudha e dytë e sundimit Austriak do të vazhdojë nga 1814-1918 e kështu me radhë deri më vitin 2006 kur Mali i Zi si shtet fiton pavarësinë - Republikë e Malit të Zi.

Tërmetet me pasoja katastrofale kanë qenë të shpeshta në historinë e Kotorrit. Njëri ndër t'a ka qenë më 6 prill 1667, nga i cili tërmet janë rrënuar dy të tretat e ndërtimeve të qytetit. Tërmeti i fundit katastrofal ka qenë më 15 prill 1979 nga i cili qyteti ka pësuar rrënimë të mëdha. Pas ndihmave që i'u janë ofruar qytetit për rindërtimin e saj, në tetor të vitit 1979 Kotorri hyn në në listën botërore të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të UNESCO-s.

Sot qeverisja dhe menaxhimi e monumenteve kuturore bëhet nga Instituti për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ndërsa për lokalitetet arkeologjike është Qendra për konzervim të arkeologjisë së Malit të Zi me qendër në Cetinje dhe me një degë në Kotorr.



Sheshi i armëve - është sheshi i parë dhe më i madhi në qytet, edhe emrin e ka marrë nga qëllimi i tij ku janë mbajtur armët në periudha të caktuara. Vizitori kalon nëpër dyer të qytetit të ndërtuara 1555, të cilat janë të ndërtuara nga blloqet masive të gurit dhe konsiderohet si hyrje kryesore nga tri hyrje që i ka qyteti i vjetër i Kotorrit. Në pozitën qendrore të sheshit gjendet **Kulla e sahatit**, që është njëri ndër simbolet e qytetit, e ndërtuar më 1602. Në pjesën e përparme të saj gjendet "shtylla e ndëshkimit" që i përket periudhës mesjetare, para së cilës janë lexuar aktgjykimet dhe janë dënuar të burgosurit.

Në pjesën balllore të sheshit gjendet "**Pallati i të pastrehëve**" (shek XVIII), që në vehte ka portalin me stilin gotik që është njëri ndër elementet më të rëndësishme apo njëherit si kryevepër e lulëzimit të stilit gotik për këtë vend.



Sheshi i miellit - emrin e ka marrë për arsye të depove të miellit që janë ruajtur në këtë shesh. Në këtë shesh kanë jetuar dy familje fisnike që kanë pasë pallatet e tyre si **Pallati Buça** dhe **Pallati Pima**. Pallati Buça është ndërtuar kah fillimi i shek XIV nga familja Buça e cila në atë kohë ka pasë ndikim të madhë në qytetin e Kotorrit, ndërsa Pallati Pima është ndërtuar pas tërmetit të vitit 1667, ka një stil të arkitekturës së renesansës dhe me elemente të barokut.





Sheshi i Shën Tripunit - është njëri ndër sheshet kryesore të qytetit në të cilin gjenden edhe



institucionet kryesore të saj si: **Katedrales e Shën Tripunit**, Ndërtesa e komunës (shek. XIX), Arkiva historike e Kotorrit, Instituti për mbrojtjen e monumenteve kulturore të Kotorrit etj. Në këtë shesh janë tubuar banorët e Kotorrit përgjatë shekujve dhe në këtë vend janë marrë vendime të rëndësishme. Thirrjet për tubim janë realizuar nga këmbanat e Katedrales së Shën Tripunit e cila është ndërtuar nga 1124-1166 kur edhe është hapur. Katedrales ka një stil Romanik me elemente të arkitekturës Bizantine. Ajo e ka ndryshuar pamjen e saj për arsye të termeteve shkatërruese dhe të rekonstruara shumë herë.



Objekti i Arkivës së Kotorrit gjendet në anën e kundërt të Katedrales. Në koleksionet e saja arkivore gjenden dokumentet e çmuara të cilat dëshmojnë për rrethanat historike dhe kulturore të Kotorrit dhe më gjerë.

Sheshi i Muzeut - dikur është quajtur Sheshi i qarkut sepse në objektin e pallatit Gregorian dikur ka qenë qeveria e qytetit, ndërkaq sot quhet Sheshi i muzeut sepse Pallati Gregorian është shëndruar në Muze Detar të Marinës. Pallati është ndërtuar nga familja Gregorina në shek.XVIII. Më 1813 pallati i dhurohet qytetit dhe përveq qeverisë së saj aty ka qenë e vendosur edhe Komanda Ushtarake Austriake. Sot muzeu ka disa koleksione të cilat janë të lidhura me detarinë dhe marinarët si: Portretet e marinarëve të famshëm, modelet e anijeve detare, paisjet detare dhe gjëra të tjera që kanë qenë të lidhura me detarinë.



Në afërsi të muzeut gjendet **Karampana** - bunar publik, çeshme e qytetit, gjithashtu një nga simbolet e qytetit e cila është ndërtuar në shek.XVII. Karampana është vendi ku gratë kanë shku me mbushë ujë, edhe pse ky nuk kishte qenë qëllimi i vetëm i shkuarjes, aty janë marrë vesh lajmet më të reja që kanë ndodhë në qytet dhe më gjerë.



Sheshi i Shën Lukës - Në këtë shesh gjendet edhe Kisha e Shën Lukës (në bazë të të cilit edhe është emërtuar sheshi) e cila është ndërtuar më 1195, e cila është një përzierje e arkitekturës Romanike me atë Bizantine. Mënyra e ndërtimit, përpunimi i gurit si dhe plastika e punuar nga guri e cila e dekoron kishën kanë theks Romanik, ndërkaq koncepti hapësinor i takon tipit Bizantin të kishës një anijatëshe me kupollë.



Dyert e lumit janë të ndëruara më 1540, në kujtim të sulmit të admiralit turk mbi Kotorrin më 1539. Dyert e lumit kanë dalje direkte në lumin Shkurda i cili buron diku në afërsi dhe kalon përgjatë mureve të qytetit.

Muret e qytetit të Kotorrit e rrethojnë bërthamën e vjetër të qytetit. Ato fillojnë nga bregdeti dhe ngriten gjer te kalaja e Shën Gjovani në 250m' l.m.d. Trashësia e këtyre mureve është nga 2-16m', ndërkaq lartësia deri në 20m'. Ky sistem kompleks i mureve mbrojtëse është ndërtuar me shekuj. Është e sigurtë se ndërtimi i mureve është bërë gjatë qeverisjes Bizantine të qytetit. Ato gjatë gjithë kohës kanë qenë të mbrojtura dhe të rindërtuara. Forma e tyre aktuale është kryesisht nga shek. XVI-XVIII, nga periudha e administrimit të Venedikut.



Në fund çfarë të themi për Kotorrin, një qytet 2000 vjeçar. Qytet i cili ka pasur rreth 20 administrime dhe qeverisje të ndryshme, qytet që ka përjetuar 4 tërmete shkatërruese, i rrethuar shumë herë, shumë herë edhe marinarët e vendit nuk janë kthyer nga lundrimi...por edhe për kundër gjithë kësaj në qytet janë ndërtuar kishat dhe pallatet, është pikturuar janë bërë skulptura, me artizanate të ndryshme,...i tillë është fati i qyteteve, për të krijuar dhe përcjellur me shekuj. Në të vërtetë, ata janë, mu sikur deti, të padepërtueshëm.



4 Vizita në qytetin Perast



Qyteti i vjetër Perasti, i takon komunës së Kotorrit, me diku rreth 250 banorë. Emri i tij daton nga një fis Ilir me emrin Pirusta.

Që nga ditët e hershme Perasti ishte i orientuar nga deti dhe detarija. Që nga viti 1336 Perasti ka pasur kantier për ndërtim anijesh i cili ka punuar deri më 1813. Statusin e komunës e ka fituar më 1580-1950. Lulëzimin më të madh Perasti e fiton gjatë shekujve XVII-XVIII, duke i'u falënderuar detarisë, kështu që edhe ndërtimet më monumentale i takojnë kësaj periudhe.



Perasti shtrihet në kodrën e Shën Ilisë, në afërsi bregdetit. Qyteti i sotëm përbëhet nga një rrugë përgjatë detit, e cila lidhet me pjesët tjera të qytetit me shkallë. Ndërtimet janë kryesisht shtëpi banimi me etazhitet të ulët P+1 ose 2. Në qendër të qytetit gjendet tregu dhe kisha e Shën Nikollës me një këmbanore të gjatë 55m'.

Në hyrje të qytetit gjendet muzeu i tij, që është një shtëpi që i përket shek. XVII si model i arkitekturës së renesansës dhe barokut.



Në mbrendi të detit afër Perastit gjenden dy ishuj, njëri është natyror me kishën e Shën Gjorgjit dhe tjetri është ishull artificial dhe me kishën "**Zonja e Shkëmbit**" e cila ka një histori shumë interesante. Diku rreth vitit 1452 në këtë ishull ka qenë një shkëmb i madh në të cilin peshkatarët e kanë gjetur një ikonë të Shën Mërisë me Jezusin, ikonë kjo e cila ka shëruar njerëzit e Perastit nga sëmundjet. Banorët e kësaj ane e kanë konsideruar këtë ikonë si "Shenjë e Perëndisë" dhe që atëherë në vendin e shkëmbit janë gjuajtur gurë të ndryshëm në shenjë ndërtimi të ishullit dhe të kishës e cila i dedikohet Shën Mërisë dhe Jezusit.



Më 22 korrik është shënuar data, ku në formë rituali, me barka meshkujt e këtyre anëve gjuajnë gurë në afërsi të këtij ishulli. Kisha e ndërtuar në të është e shek. XVII, freskat e kësaj kisha janë skenat e jetës së Shën Mërisë dhe të Jezusit. Në pjesën anësore të mureve të kishës gjenden disa pllaka në kuadër të së cilave janë të vendosura punimet e peshkatarëve në periudha të ndryshme të punuara nga argjendi.

Perasti sot është një qytet shumë i qetë, ku jeta e bujshme, pasuria dhe festimet e saj sot janë vetëm një histori. Megjithatë me bukurinë e Perastit, joshen shumë marinarë, udhëtarë, artistë, ëndrimtarë, ata që e dëshirojnë të bukurën dhe qetësinë.



Si përfundim

Nuk është e mjaftueshme që të kemi ne si Kosovë vetëm Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme (të përpiluar nga MKRS)!

- Nevoitet që të mbrohen këto monumente (Si?)
- Të zhvillohen këto monumente (Si?)
- Të promovohen monumentet, të promovohet trashëgimia e luajtshme, trashëgimia shpirtërore me të cilën mund të krenohemi (Si?)

Me bashkëpunim më konkret të Ministrive të cilat ballafaqohen me çështjen e TK dhe TN në këtë rast MKRS, MMPH dhe MTI, duke mos anashkaluar edhe bashkëpunimin me komuna, përmes projekteve të përbashkëta do të mund të realizohen nevojat e cekura më lartë.

